

VENDIM
Nr. 727, datë 13.12.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 538, DATË 29.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË DETAJUARA PËR NGRIRJEN E PËRKOHSHME TË FONDEVE APO TË PASURIVE TË TJERA TË PERSONAVE OSE ENTEVE TË SHPALLURA NGA STRUKTURAT PËRKATËSE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA APO ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, KU REPUBLIKA E SHQIPËRISË ËSHTË PALË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10/1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kudo në vendimin nr. 538, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku